



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 03 Prill 2023

Nr: 433

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 229 ID, NGA QENDRA "QËNDRESA QYTETARE" PËR Z. GENCI DEMIRAJ, DREJTOR I QENDRËS SË KULTURËS DHE ARTIT VLORË DHE SUBJEKTIT ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË" PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 03 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:** Qendra "Qëndresa Qytetare"

**SUBJEKT:** Z. Genci Demiraj, drejtor i Qendrës së Kulturës dhe Artit Vlorë  
Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë"

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ për shkelje në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenit 9 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur denoncimi i datës 7.3.2023, i administruar pranë nesh me shkresën nr. 2236 prot., datë 30.03.2023, me denoncues Qendra "Qëndresa Qytetare". Pala denoncuese pretendon se ka patur përdorim të burimeve publike, në mbështetje të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", me përdorimin e ambienteve të kinemasë Vlorë,

Data: 03 Maj 2023

Nr: 433  
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 229 nga Qendra "Qëndresa Qytetare"

për qëllime zgjedhore. Gjithashtu denoncuesi pretendon se pjesëmarrja e të rinjve në këtë aktivitet nuk ka qenë me vullnetin e tyre të lirë.

Në denoncimin me nr. 229 ID të qendrës “Qëndresa Qytetare” pretendohet si më poshtë vijon:

*“1. Më datë 1 Mars 2023, deputeti i Kuvendit të Shqipërisë z. Blendi Klosi ka postuar në rrjetin e tij social ‘Facebook’ postimin me përmbajtjen e mëposhtme: Pasditja në Vlorë me të rinj votues për herë të pare, që do të sjellin edhe ata fitoren në 14 Maj të PS për Vlorën tonë. Partia Socialiste - familja jonë e përbashkët politike, që ka ruajtur të njëjtën frymë pranë njerëzve dhe me njerëzit, partia që garanton të ardhmen evropiane EU. Energji rinore, vullnet, bashkëpunim”.*

*2. Sipas denoncimeve të mbërritura në adresën e qendrës "Qëndresa Qytetare" dhe siç verifikohet lehtësisht, aktiviteti me të rinjtë që janë votues për herë të parë, është zhvilluar në ambientet e kinemasë së qytetit të Vlorës. Për më tepër, po sipas denoncimeve, të rinjtë pjesëmarrës në këtë takim nuk kanë qenë me vullnetin e tyre të lirë, por janë detyruar të marrin pjesë në aktivitet.”*

Denoncuesi pretendon se nëpërmjet kryerjes së aktivitetit të mësipërm është përdorur një burim publik në mbështetje të subjekteve zgjedhore, referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, dhe ka kërkuar sanksionimin e personave përgjegjës.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtarinë publike, për të cilën ekziston dyshim i arsyeshëm, se është kryer në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Më datë 30.3.2023 bashkisë Vlorë i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike, ku ndër të tjerash personi përgjegjës për bashkinë Vlorë, është pyetur rreth:

1. Çfarë statusi ka kinemaja e qytetit të Vlorës dhe nëse mund të përdoret për aktivitete të tjera, përveç atyre që është e destinuar për t'u përdorur?
2. Nëse salla e kinemasë është dhënë për përdorim për subjektin zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", ju lutemi paraqisni kontratën e qirasë, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Nga kush menaxhohet kinemaja e qytetit të Vlorës?

Më datë 20.04.2023, bashkia Vlorë na ka përcjellë shkresën e "Qendres së Kulturës dhe Artit Vlorë" me nr. 20 prot., datë 7.04.2023 ku jemi informuar se "Referuar legjislacionit në fuqi, ka vendosur në dispozicion ambientet e kinemasë, kundrejt qirasë ditore, me vlerë 20.000 (njëzet mijë) lekë". Bashkëngjitur kësaj shkrese janë dërguar:

- 1- Kërkesa e subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë";
- 2- Kontrata me nr. 27 prot., datë 01.03.2023;
- 3- Fatura për arkëtim me nr. 7, datë 01.03.2023.

Më datë 30.3.2023, Zyrës Vendore Arsimore Vlorë –Himarë i është kërkuar informacion mbi pjesëmarrjen e të rinjëve në këtë aktivitet elektorale, si dhe nëse ka patur ftesë nga organizatori për pjesëmarrjen e tyre, në drejtoritë e shkollave nën juridiksionin e ZVA Vlorë-Himarë.

Më datë 5.4.2020, Zyra Vendore Arsimore Vlorë-Himarë na ka informuar se "Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë-Himarë nuk ka dijeni mbi zhvillimin e këtij aktiviteti dhe pjesëmarrësit në të. Pranë Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar apo në drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare nuk është paraqitur asnjë ftesë nga asnjë subjekt për pjesëmarrjen e nxënësve në këtë aktivitetet. Të gjitha institucionet arsimore parauniversitare në varësi të ZVAP-it Vlorë-Himarë janë njohur me aktet ligjore e nënligjore në fuqi të cilat ndalojnë përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve. Për sa më sipër, nuk kemi informacion nëse në këtë aktivitet kanë marrë pjesë të rinj nga shkollat nën juridiksionin tonë".

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur.

Në këtë seancë u paraqit përfaqësuesi i qendrës "Qëndresa Qytetare" z. Dhimitër Zguro, por nuk pati asnjë të pranishëm nga ana e bashkisë Vlorë dhe ZVA Vlorë-Himarë.

Në seancën publike, përfaqësuesi i qendrës “Qëndresa Qytetare”, mbështeti edhe njëherë pretendimet e tij, të paraqitura në menyrë shkresore me denoncimin regjistruar me nr. 229 ID regjistër.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të hetimit administrativ vlerësoi se:

Kinemaja e qytetit të Vlorës është ambient, i cili për nga funksioni i shërben qytetarëve kundrejt pagesës. Mënyra e **funksionimit dhe qëllimi i përdorimit të këtyre ambienteve** rregullohet me dispozita ligjore të veçanta. Ligji i posaçëm prevalon në zbatimin e tij me dispozitat e përgjithshme, siç është Kodi Zgjedhor. Vendimi nr. 79, datë 2.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë” të Këshillit Bashkiak Vlorë ka përcaktuar tarifat për përdorimin e ambienteve publike, kundrejt procedurave standarde të marrjes me qira ditore. Përcaktimi i këtyre tarifave, tregon edhe qëllimin tregtar për dhënien në përdorim të këtyre ambienteve.

Referuar nenit 91, pika 1, e i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, shprehet se “*Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike*”. Ligji ndalon vendosjen e institucioneve publike në favor të subjekteve zgjedhore për të garantuar një fushatë të barabartë për garuesit. Megjithatë vetë ligji parashikon se “**me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj**”, burime të ndryshme publike mund të vendosen edhe në dispozicion të subjekteve zgjedhore, partive politike apo kandidatëve të cilët marrin pjesë në zgjedhje.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se në rastin që do të vërtetohej dhënia në përdorim e këtyre ambienteve, duke anashkaluar procedurat ligjore dhe detyrimet financiare që rrjedhin nga kontrata e qirasë, atëherë do të konstatohej shkelja e nenit 91, të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, për aq kohë sa nuk ka favorizim për dhënien në përdorim të këtyre ambienteve, për subjektet zgjedhore, vlerësoj të përligjur përdorimin e këtyre ambienteve.

Ambientet, **që për shkak të funksionit** dhe mundësive akomoduese që ofrojnë dhe **kur dhënia në përdorim, bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të caktuara**, mund të përdoren nga subjektet zgjedhore. Për sa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj drejtorit të Qendrës së Kulturës dhe Artit z. Genci Demiraj dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, duke mos konstatuar shkeljen e pikës 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor.

## II.

Denoncuesi pretendon se pjesëmarrja e të rinjve në këtë aktivitet elektorale ka qenë pa prezencën e vullnetit të tyre të lirë.

Data: 03 Maj 2023    Nr: 433  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 229 nga Qendra  
“Qëndresa Qytetare”

Referuar pikës 2 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor “Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si **dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore**. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.

Neni 3, pika 1, nëndarja 1.3, shkronja “ç” e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator parashikon se konsiderohet veprimtari i ndaluar: “përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe **përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim”.**

Vlerësoj se, që të konstatohet shkelja duhet të vërtetohet “**përdorimi i detyruar**” dhe “**organizmi i aktivitetit brenda orarit mësimor**”. Gjatë hetimit administrativ, referuar dhe përgjigjes së administruar nga ZVA Vlorë-Himarë, nuk u arrit të provohej pjesëmarrja me detyrim dhe brenda orarit mësimor i të rinjve. Gjithashtu, konsiderojmë të arsyeshme të sqarohet se terminologjia “votues për herë të parë”, jo domosdoshmërisht referon për nxënës pjesë e sistemit shkollor parauniversitar. Për sa më sipër, vlerësojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ duke mos konstatuar shkeljen e pikës 2, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe neni 3, pika 1, nëndarja 1.3, shkronja “ç” e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neni 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

#### **V E N D O S:**

1. Pushimin e procedimit administrativ për drejtorin e Qendrës së Kulturës dhe Artit Vlorë dhe për subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Moskonstatimin e shkeljes për drejtorin e Qendrës së Kulturës dhe Artit Vlorë dhe për subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Data: 03 Maj 2023    Nr: 433  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 229 nga Qendra  
“Qëndresa Qytetare”

3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 03 Maj 2023    Nr: 433  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 229 nga Qendra  
“Qëndresa Qytetare”